

Fshirja në zyrën anagrafike të popullatës rezidente në Komunë

Përshkrimi

Fshirja në zyrën anagrafike të popullatës rezidente në Komunë mund të ndodh për arsye e mëposhtme:

- vdekje;
- emigrimi në një Komunë tjetër (duke prezantuar deklarin e rezidencës në Komunën e re);
- emigrimi jasht vendit (duke përdorur modularin e duhur të sjellë më posht);
- pa mundësi e verifikimit ose e regjistrimit;
- jo rinovim i deklarin të vendbanimit të zakonshëm në Komunë (vetëm për nënshtetasit e huaj, që nuk i përkasin Komunitetit Europian)

Nuk sjell efekte fshirje të rezidencës mungesa e përkohëshme në Komunën e vendbanimit të zakonshëm, kur personi gjendet në një qytet tjetër ose jasht vendit për motive studimi, pune ose për arsye të tjera kontingjente të cilat zgjasin për një kohë të limituar, m.gj.th jo më shumë se 1 vitë.

Në rastin kur është kryer fshirja, duhet të prezantohet një kërkesë e re [deklaratë vendbanimi/rezidence](#).

Fshirja në zyrën anagrafike për vdekje

Në rast vdekje (e deklaruar dhe nga ana gjyqësore), familiarët e të ndjerit nuk duhet të bëjnë asnjë komunikim në Zyrën Anagrafike, pasi do të jetë detyra e Zyrtarit të Gjendjes civile të Komunës ku ka ndodhur vdekja, ta komunikojë atë Zyres Anagrafike të Komunës së rezidencës.

Zyra Anagrafike siguron komunikimin telematik të vdekjes së personit në Agjencinë e të Ardhurave, në I.N.P.S dhe në Motorizimin Civil dhe Trasporte në Konçension.

Fshirja në zyrën anagrafike për emigrim në një Komunë tjetër

Nënshtetasi i cili transferohet në një Komunë tjetër italiane duhet të prezantoj deklaratën e rezidencës direkt në Komunën e re. Emigrimi në një Komunë tjetër sjell fshirjen dhe regjistrimin e menjëhershëm anagrafik në Komunën e re të rezidencës. Ç' do gjë kryet automatikisht midis dy komunave e interesuara.

Fshirja në zyrën anagrafike për transferimin e rezidencës jashtë vendit

Nënshtetasi italian i cili transferohet në mënyrë defnitive jashtë vendit duhet të paraqitet në Ambasadën/Konsullatën italiane kompetente për territorin për tu regjistruar në Aire (Anagrafe për italianët rezident jashtë vendit) Konsullata do ti komunikoj Komunës italiane të rezidencës së fundit transferimin për fshirje nga popullata rezidente dhe regjistrimin në Regjistrin e italianëve Rezident/Banues Jashtë vendit

Nënshtetasit e Bashkimit Europian (komunitarë) dhe nënshtetasit e huaj (të cilët nuk bëjnë pjesë në Bashkimin Europian) që kanë si qëllim të transferohen jashtë vendit ose duan të kthehen në vendin e tyre të origjinës, duhet të prezantojnë Deklaratën e transferimit të rezidencës jashtë vendit dhe adresën e rezidencës së re duke përdorur modularin Ministerial të mëposhtëm

Fshirja në zyrën anagrafike për pamundësi verifikimi

Fshirja nga zyra anagrafike mund të kryhet për pa mundësi verifikimi kur, mbas disa verifikimeve, personi rezulton i pa kontaktueshëm. Në këtë rast procedura aktivizohet nga zyra ose në bazë të **një sinjalizimi privat**. Kjo fshirje mund të kryhet dhe si pasojë e operacioneve të përgjithshme të regjistrimit të popullsisë

Fshirja për pamundësi verifikimi sjell pamundësinë për të tërhequr çertifikatat anagrafike, dokumentat e identitetit dhe për nënshtetasit italian humjen e të drejtës për votën

Procedura e fshirjes mbyllet, si pasojë e verifikimeve të përsëritura në banesën e zakonshme, të cilat kanë dhënë rezultate negative, për një **periudh kohore minimumi një vit**.

Fshirja në zyrën anagrafike për jo rinovim të deklarimit të vendbanimit të zakonshëm në Komunë

Nënshtetasit e huaj (të cilët nuk bëjnë pjesë në Bashkimin Europian) mund të fshihen nga zyra për mungesën e rinovimit të deklarimit të banesës së zakonshme në Komunë.

Normativa në fuqi parashikon që nënshtetasit e huaj të regjistruar në zyrën anagrafike **kanë si detyrim** të prezantojnë në Komunë deklaratën e rinovimit të banesës së zakonshme, **së bashku me kopien e lejes së qëndrimit të re**, në bazë të procedurave të mëposhtme.

Mbasi kalojnë 180 ditë nga skadimi i lejes së qëndrimit dhe n.q.f nënshtetasi nuk rinovon deklarimin e vendbanesës së zakonshme, Zyra Anagrafike e fton të paraqesi lejen e qëndrimit të rinovuar, duke bërë njëkohësisht deklaratën e vendbanesës së zakonshme

Mënyrat e kërkesës

Sinjalizimet nga ana e të interesuarve për kërkesën e fshirjes anagrafike mund të kryen duke prezantuar modularin e mëposhtëm, i shoqëruar nga e një dokumenti të identitetit të vlefshëm, në baz të procedurave të mëposhtme:

- personalisht në [Sportelin Multifunksional](#) , gjatë orareve të hapjes me publikun
- me anë të postës rekomandë, e cila duhet dërguar në zyrën anagrafike të Komunës në adresën e më poshtme: Komuna e Campi Bisenzio Sheshi Dante n. 36 CAP 50013 - CAMPI BISENZIO (FI);
- me fax në numrin 055/8959446;
- me anë të PEC në adresën comune.campi-bisenzio@postacert.toscana.it me anë të postës së çertifikuar të deklaruesit;
- me anë të postës elektronike të thjeshtë në Email-in anagrafe@comune.campi-bisenzio.fi.it duke firmosur në mënyrë dixhitale deklaratën ose duke bashkangjitur kopien e deklarates e cila përmban firmën e autografuar dhe kopien e dokumentit të identitetit të deklaruesit të përfituar me anë të skanerit

Normativat e referimit

Ligji i 24 dhjetorit 1954, n. 1228 "Urdhrat anagrafike të popullatës rezidente"

D.P.R. 30 maj 1989, n. 223 "Rregullorja anagrafike të popullatës rezidente"

Ligji 15 korrik 2009, n. 94 "Dispositivat në lidhje me sigurinë publike"

Ligji 4 prill 2012, n. 5 të konvertimit në dekret ligjor të 9 shkurtit 2012, n. 5 "Dispozitiva urgjente në lidhje me thjeshtëzimin dhe zhvillimin"

Modulistika

 [Modulari i kërkesës së fshirjes së rezidencës për jo verifikim \(81.8 KB\)](#)

 [Deklarata e transferimit të rezidencës jasht vendit \(70.54 KB\)](#)